



Ligjërata 8

Analiza Kosto-Vëllim-Fitim

KONTABILITETI MENAXHERIAL

© 2014 Ylber Prekazi

Java e tetë

- Konceptet kryesore të analizës kosto-vëllim-fitim
- Pika e ekuilibrit (pika kritike)
- Paraqitja grafike e marrëdhënieve kosto-vëllim-fitim
- Analiza e ndjeshmërisë dhe analiza KVF

Pyetjet që kërkojnë përgjigje!

- Cili do të ishte efekti në fitim, në qoftë se ne ulim çmimin e shitjes dhe shesim më tepër njësi produkti?
- Çfarë vëllimi shitjesh kërkohet për të përballur shpenzimet fikse shtesë që rrjedhin nga një fushatë marketing?
- A duhet paguhen punonjësit e shitjes mbi bazën e një shpërblimi, komisioni, apo kombinimit të të dyjave?
- ❖ *Këtyre dhe pyetjeve të tjera mund t'u jepet përgjigje duke përdorur analizën **Kosto-Vëllim-Fitim (KVF)**.*

1-3

Konceptet kryesore të analizës kosto-vëllim-fitim

- **Analiza K-V-F** është mjet i rëndësishëm për planifikimin dhe marrjen e vendimeve.
- **Pika e ekuilibrit** është pika ku të ardhurat barazohen me koston totale, pika ku nuk ka as fitim as humbje.

1-4

PRAGU I RREZIKUT

Është faktor me rëndësi në procesin e marrjes së vendimeve afat shkurtëra përmes studimit të raporteve në mes vëllimit të prodhimit, shpenzimeve dhe të hyrave në shkallë të ndryshme të aktivitetit

Vendime tipike të tilla afat shkurtëra janë:

1. Vendimet mbi shitjen
2. Politika e çmimeve
3. Pranimi i ofertës speciale, etj.



MARZHA E KONTRIBUTIT

- Marzha e kontributit paraqet konceptin për llogaritjen e rrezikut në pikën prag të falimentimit apo në pikën e thyerjes
- Zakonisht përdoret në analizën e kostos variable dhe në analizën e vëllimit të prodhimit dhe të profitit

...MARZHA E KONTRIBUTIT

Shitjet (50,000 njësitë)	€1,000,000
Kosto variable	600,000
Marzha e kontributit	€ 400,000
Kosto fikse	300,000
E ardhura nga operacionet	€ 100,000

Marzha e kontributit është në dispozicion për të mbuluar koston fikse dhe të ardhurën nga operacionet



...RAPORTI I MARZHËS SË KONTRIBUTIT

Shitjet (50,000 njësitë)	€1,000,000	100%	€20
Kosto variabile	600,000	60%	12
Marzha e kontributit	€ 400,000	40%	€ 8
Kosto fikse	300,000	30%	
E ardhura nga operacionet	€ 100,000	10%	

Marzha e kontributit mund të shprehet në tri mënyra:

1. Marzha e kontributit totale në euro
2. Raporti i marzhës së kontributit (përqindja)
3. Marzha e kontributit për njësi (euro në njësi)

Shembull i pikë-thyerjes

- Supozojmë se kostot fikse janë €90,000.
- Sa njësi duhet të shiten me çmim prej €100 për të arritur pikë-thyerjen?
- $(€100 \times \text{njësitë e shitura}) - (€70 \times \text{njësitë e shitura}) - €90,000 = 0$
- $\text{Njësitë e shitura} = €90,000 \div €30 = 3,000$

Marzha e kontributit

	Për njësi	Përqindja	Raporti
Çmimi shitës	€100	100	1.00
KV	70	70	.70
MK	€ 30	30	.30

Formula e marzhës së kontributit

$(\text{Kostot fikse} + \text{E ardhura operative}) \div \text{MK për njësi} = \text{Njësitë}$

$(€90,000 + 0) \div €30 = 3,000 \text{ njësi}$

Formula e marzhës së kontributit

$$\text{Pragu i rrezikut} = \frac{\text{Shpenzimet fikse}}{\text{Kontributi i mbulimit për njësi}}$$

apo:

$$\text{Pragu i rrezikut} = \frac{\text{Shpenzimet fikse}}{\text{Kontributi i mbulimit}} \times \text{Çmimi shitës}$$

KALKULIMI I PRAGUT TË RREZIKUT

Shitjet (? njësitë)	€	?	€25
Kosto variabile		?	15
Marzha e kontributit	€	90,000	€10
Kosto fikse		90,000	
E ardhura nga operacionet	€	0	

Në pragun e rrezikut, kosto fikse dhe marzha e kontributit janë të barabarta

...KALKULIMI I PRAGUT TË RREZIKUT


Në njësi

Shitjet (€25 x 9,000)	€225,000	€25
Kosto variabile (€15 x 9,000)	<u>135,000</u>	<u>15</u>
Marzha e kontributit	€ 90,000	€10
Kosto fikse	<u>90,000</u>	
E ardhura nga operacionet	€ 0	


$$\text{Shitjet në pragun e rrezikut (njësi)} = \frac{\text{Kosto fikse (€90,000)}}{\text{Marzha e kontributit për njësi (€10)}}$$

= 9,000 njësi


Analiza e K-V-F




Analiza e K-V-F




Analiza e K-V-F




Analiza e K-V-F



Analiza e K-V-F



Analiza e K-V-F



APLIKIMI I ANALIZËS SË KOSTOS - VËLLIMIT - FITIMIT



ANALIZA SPECIALE E PRAGUT TË RREZIKUT

Arritja e nivelit të kënaqshëm të pragut të rrezikut dhe përmirësimi i përhershëm i atij niveli i shndërruar në rritjen e kontributit dhe të neto profitit të ndërmarrjes në periudhën konkrete përlogaritëse, mund të arrihet me:

- *Ndryshimet në çmimin e shitjes*
- *Ndryshimet në kostot variabile*
- *Ndryshimet në kostot fikse*

Ndryshimet në çmimin shitës

- Supozojmë se çmimi shitës për njësi është rritur në €106 nga €100.
 - Çfarë sasive duhet shitur për të arritur pragun e rrezikut?

Marzha e re e kontributit $€106 - €70 = €36$

Pragu i rrezikut: $€90,000 \div €36 = 2,500$ njësi

Ndryshimet në kostot variabile

- Supozojmë se kostot variabile për njësi rriten në €75 në vend të €70.
- Faktorët tjerë kanë mbetur të panjohur.
$$€90,000 \div €25 = 3,600$$
$$€90,000 \div 0.25 = €360,000$$

Ndryshimet në kosto fikse

- Supozojmë se qiraja është rritur për €30,000.
- Çfarë janë kostot fikse?
- $€90,000 + €30,000 = €120,000$
- Çfarë është pragu i rrezikut?
- $€120,000 \div €30 = 4,000$ njësi
- $€120,000 \div 0.30 = €400,000$

PROFITI ÇAK

Në njësi

Shitjet (? njësitë)	€	?	€27
Kosto variable		<u>?</u>	<u>16</u>
Marzha e kontributit	€	?	€11
Kosto fikse		<u>84,000</u>	
E ardhura nga operacionet	€	<u><u>0</u></u>	

Kostot fikse janë vlerësuar në €84,000 si dhe profiti i dëshiruar në €20,000.
Çmimi shitës për njësi është €27 dhe kosto variable për njësi €16.

...PROFITI ÇAK

Në njësi

Shitjet (? njësitë)	€	?	€27
Kosto variable		<u>?</u>	<u>16</u>
Marzha e kontributit	€	?	€11
Kosto fikse		<u>84,000</u>	
E ardhura nga operacionet	€	<u><u>0</u></u>	

Profiti çak është shfrytëzuar këtu për të ju referuar "të ardhurave nga operacionet."

$$\text{Shitjet (njësi)} = \frac{€84,000 + €20,000 \text{ (Kosto fikse + Profiti çak)}}{€11 \text{ (Marzha e kontributit për njësi)}}$$

= 9,455 njësi

...PROFITI ÇAK

Shitjet (9,455 njësitë x €27) €	255,285	€27
Kosto variabile (9,455 x €16)	<u>151,280</u>	<u>16</u>
Marzha e kontributit €	104,005	€11
Kosto fikse	<u>84,000</u>	
E ardhura nga operacionet €	<u>20,005</u>	

U vërtetua se shitjet prej 9,455 njësive me çmim prej 27 ofrojnë profit €20,005

STRUKTURA E KOSTOVE DHE LEVERAZHI AFARIST

- Leverazhi financiar, shpreh raportin e borxhit në ekuitet ($L = B/E$) dhe iu referohet madhësisë që biznesi financohet nga borxhet në raport me ekuitetin. Sa më i madh borxhi, aq më i madh leverazhi financiar.

STRUKTURA E KOSTOVE DHE LEVERAZHI AFARIST

- Leverazhi operativ është nocion apo koncept më pak i njohur. Edhe nëse ju nuk huazoni para, ju nuk mundeni domosdoshmërisht t'i ikni rrezikut të leverazhit operativ. Leverazhi operativ mat koston fikse në raport me atë variable. Me fjalë tjera, leverazhi operativ shpreh përqindjen e kostove fikse në strukturën e kostove të kompanisë.

STRUKTURA E KOSTOVE DHE LEVERAZHI AFARIST

- Kontabilisti menaxherial mund të mat leverazhin operativ të kompanisë, në vëllim të caktuar të shitjes, duke përdorur faktorin e leverazhit operativ:

$$\text{Faktori i leverazhit operativ} = \frac{\text{Marzha e kontributit}}{\text{E ardhura neto}}$$

STRUKTURA E KOSTOVE DHE LEVERAZHI AFARIST

- Analiza e pragut të rrezikut shpesh herë shfrytëzohet në ndërthurje me leverazhin operativ. Ashtu si rritet shitja përtej pragut të rrezikut, efektet e leverazhit operativ pakësohen. Duke shfrytëzuar analizën e pragut të rrezikut, ne mund të kalkulojmë leverazhin operativ:

$$\text{Shkalla e leverazhit operativ (SHLO)} = \frac{\% \text{ e ndryshimeve në FPIT}}{\% \text{ e ndryshimeve në shitjen}}$$

LEVERAZHI FINANCIAR DHE LEVERAZHI AFARIST

Apo:

$$\text{ShLO} = \frac{(\text{Shitja} - \text{Kostot variabile})}{(\text{Shitja} - \text{Kostot variabile} - \text{Kostot fikse})}$$

Shembull: Çmimi i produktit = 10 €, Kosto variabile për njësi = 6 €, Kostot fikse = 12.000 €, Sasia e shitur = 5.000 njësi

Nëse aplikojmë formulën e fundit, rezultati do të jetë:

$$\text{ShLO} = \frac{(50.000 \text{ €} - 30.000 \text{ €})}{[(50.000 \text{ €} - 30.000 \text{ €}) - 12.000 \text{ €}]}$$

$$\text{ShLO} = 20.000 / 8.000$$
$$\text{ShLO} = 2,5$$

MARZHA E SIGURISË



MARZHA E SIGURISË

Sa i përket kalkulimit të të ardhurës (fitimit) operative të synuar, këtë mund ta ilustrojmë me pyetjen: Sa njësi duhet shitur kompania me qëllim të fitimit të një të ardhure operative prej një shume të caktuar?

MARZHA E SIGURISË

$$\text{Marzha e sigurisë} = \frac{\text{Shitjet} - \text{Shitjet në pragun e rrezikut}}{\text{Shitjet}}$$

$$\text{Marzha e sigurisë} = \frac{€250,000 - €200,000}{€250,000}$$

$$\text{Marzha e sigurisë} = 20\%$$

Marzha e sigurisë tregon uljet e mundshme në shitje që mund të shkaktohen para se të rezultojë humbja operative

...MARZHA E SIGURISË

APO:

Marzha e sigurisë

=

Shitja totale

–

Shitja në pragun e rrezikut

...MARZHA E SIGURISË

- Nëse dëshirojmë të shohim ndikimin e taksës në profit në analizën e C-V-P, përdorim formulën vijuese:

Profiti neto i synuar

- E ardhura operative e synuar = $\frac{\text{Profiti neto i synuar}}{1 - \text{Shkalla e taksave}}$

- Nëse shfrytëzojmë të dhënat e shembullit të mësipërm duke supozuar se shkalla e taksës në fitim është 20 %, kemi:

100.000 €

- E ardhura operative e synuar = $\frac{100.000 \text{ €}}{1 - 20 \%} = 125.000 \text{ €}$

...MARZHA E SIGURISË

- Po ashtu, ne mund të shfrytëzojmë metodën e marzhës së kontributit me qëllim të përcaktimit të ardhurës operative të synuar, sipas formulës vijuese:

Sasia e prod. që kërkohen për tu shitur = $\frac{\text{Kostoja fikse} + (\text{Profiti neto i synuar} / [(1 - \text{shkalla e taksës})]}{\text{Marzha e kontributit për njësi}}$

Sasia e produkteve që kërkohen për t'u shitur = $\frac{200.000 \text{ €} + 125.000}{30} = 10.833 \text{ njësi}^*$



Shqyrtimi i shitjeve të përziera

NN Company ka shitur 8,000 njësi të produktit A dhe 2,000 njësi të produktit B gjatë vitit të kaluar. Kosto fikse e NN Company është €200,000. Të dhëna tjera relevante janë:

	Produktet	
	A	B
Shitjet	€ 90	€140
Kosto variabile	<u>70</u>	<u>95</u>
Marzha e kontributit	€ 20	€ 45
Shitjet e përziera	80%	20%

Shqyrtimi i shitjeve të përziera

	Produktet	
	A	B
Shitjet	€ 90	€140
Kosto variabile	<u>70</u>	<u>95</u>
Marzha e kontributit	€ 20	€ 45
Shitjet e përziera	80%	20%
Marzha e kontributit e produktit	€16	€ 9
	} €25	

Kosto fikse, €200,000

Shqyrtimi i shitjeve të përziera

Marzha e kontributit e produktit

Produktet	
A	B
€16	€ 9
} €25	

Shitjet në pragun e rrezikut (njësi)

€200,000

€25

Kosto fikse, €200,000

Shqyrtimi i shitjeve të përziera

Marzha e kontributit e produktit

Produktet	
A	B
€16	€ 9
€25	

Shitjet në pragun e rrezikut (njësi)

$$\frac{€200,000}{€25} = 8,000 \text{ njësi}$$

Kosto fikse, €200,000

Shqyrtimi i shitjeve të përziera

Marzha e kontributit e produktit

Produktet	
A	B
€16	€ 9
€25	

A: 8,000 njësi x shitjet e përziera (80%) = 6,400

B: 8,000 njësi x shitjet e përziera (20%) = 1,600

	Produkti A	Produkti B	Totali
Shitjet:			
6,400 njësi x €90	€576,000		€ 576,000
1,600 njësi x €140		<u>€224,000</u>	<u>224,000</u>
Totali i shitjeve	<u>€576,000</u>	<u>€224,000</u>	<u>€800,000</u>
Kosto variabile:			
6,400 x €70	€448,000		€ 448,000
1,600 x €95		<u>€152,000</u>	<u>152,000</u>
Totali i koston variabile	<u>€448,000</u>	<u>€152,000</u>	<u>€600,000</u>
Marzha e kontributit	<u>€128,000</u>	<u>€ 72,000</u>	<u>€200,000</u>
Kosto fikse			<u>200,000</u>
E ardhura nga operacionet	Pragu i rrezikut		<u><u>0</u></u>

Analiza e ndjeshmërisë dhe analiza KVF

- **Analiza e ndjeshmërisë** është një nga metodat për trajtimin e ndryshimeve të vlerave të variablave.
- Përmes programeve të ndryshme kompjuterike mund të studiohen kombinime të shumta, si: në çmimet e shitjeve, kostot fikse, kostot variable, etj.

